



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE VLORË

NOTER KADRI H. BILALI  
ADRESA 28 NENTORI  
TEL: 697306944



# VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 1359

Ballsh më 30/09/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2020061980066243712

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE VLORE  
NOTER KADRI H. BILALI



DATE 30/09/2020  
NR REP 1359

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 30.09. 2020, para meje Noter KADRI H. BILALI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORE, me zyrë në adresën Ballsh, lagja "28 NENTORI", Bashkia Mallakaster, u paraqite personalisht:

**NËNSHKRUESI:**

Arben Lutaj, atësia Dano, amësia Haxhire, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Shyqyri Brari; Nd. 9; H. 4; Ap. 27; Farkë; Selitë; 1045; Tiranë, lindur më 27/07/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033527128 dhe nr. personal H10727090A.


Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitë dhe nënshkroi përpara meje noterit, "Akt Themelimin e shoqërisë "FIAMA" SH.P.K; bashkëlidhur.

Unë noter, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të igjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noter deklaroj se do të ruaj dhe përpujoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER  
KADRI H. BILALI





**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"FIAMA"**

Sot, më datë 30.09.2020, une,

**THEMELUESI:**

Arben Lutaj, atësia Dano, amësia Haxhire, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Shyqyri Brari; Nd. 9; H. 4; Ap. 27; Farkë; Selitë; 1045; Tiranë, lindur më 27/07/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 033527128 dhe nr. personal H10727090A.

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqëria tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emertimin "FIAMA" shpk.

**KREU I**

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është: "FIAMA" SHPK.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "FIAMA" shpk, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga ortaku i vetem, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline në adresën **ZONA KADASTRIALE 1945, NR.PAS.274/121 HEKAL, BASHKIA MALLAKASTER**, godine banimi dhe shërbimi.

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetem.

Neni 4

Objekti

Shoqëria "FIAMA" shpk, ka për objekt:

"Kryerjen e çdo aktiviteti të lejuar me ligj dhe pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryej një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. Aktivitet në fushën e projekteve dhe hapje studio projektimi. Investitor privat dhe/ose zbatues i veprave të ndërtimit, rikonstruksionit, restaurimit, mirembajtje, sipërmarrje të ndryshme me fonde private dhe shtetërore, donacione, etj., në fushën e ndërtimit të objekteve të ndryshme civile, industriale, socialkulturore, turistike, bujqësore, landfilleve, stadiumeve, punime sipas kategorive të licencës së zbatimit NP-1, NP-2, NP-3, NP-4, NP-5, NP-6, NP-7, NP-8, NP-9, NP-10, NP-11, NP-12, NS-1, NS-2, NS-3, NS-4, NS-5, NS-6, NS-7, NS-8, NS-9, NS-10, NS-11, NS-12, NS-13, NS-14, NS-15, NS-16, NS-17, NS-18, NS-19, NS-20. Agjenci për shitbjerjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Punime mjedisore, hartim të raporteve të ndikimit në mjedis dhe ekspertime mjedisore. Grumbullim, ruajtje,

transportim dhe trajtim i mbetjeve urbane dhe mbetjeve inerte te parrezikshme. Sherbime specicioni brenda dhe jashte Shqiperise per transport mallrash te ndryshme me shumice e pakice, import – eksport me mjete te shoqerise. Import-eksport, tregtim me shumice dhe pakice i mallrave dhe pajisjeve te ndryshme industriale, bujqesore, blegtorale, elektrike, hidraulike, frigoriferike, ashensor, elektro-shtepiake/industriale, kancelari dhe artikujve shkollor, blegtorale, ushqimore, pajisjeve kondicionimit dhe ventilimit, kompjutera dhe pajisje kompjuterike, printimi, fotokopjimi si dhe pjese kembimi per to, si dhe te ofroj te gjitha sherbimet/riparime qe kryhen me pajisjet e siperpermendura. Import, eksport dhe tregtim, me shumice dhe pakice te makineri, mjete, automjete, kamiona, makineri industriale, bujqesore, blegtorale, si dhe çdo lloj mjeti dhe pajisje te motorizuar dhe pjese te kembimit per keto makineri, autoservis mjetesh te markave e tonazheve te ndryshme. Dhenie me qera e mjeteve dhe automjeteve te çdo lloji. Krijimi, instalimi, dhenia me qira dhe venia ne shfrytezim e impianteve, stacioneve, reparteve, linjave per tregtimin e hidrokarbureve brenda e jashte vendit; Import-eksport dhe tregti me shumice e pakice e naftes, gazit, nenprodukteve te tyre, vajrave lubrifikante, transport kombetar e nderkombetar i tyre. Ndertimi, marrja dhe dhenia me qira dhe venia ne perdorim te depove hidrokarbure, rezervuareve te linjave dhe pikave te shitjes se tyre sipas projektit teknologjik. Sherbim hoteleri. Agjensi turistike. Import-eksport, prodhim dhe tregtimi materiale ndertimi dhe lendeve te para industrial, drusore dhe per ndertim. Hotel, bar-kafe, restorantë. Import, eksport dhe tregtim, me shumice dhe pakice te mjete mjekesore, aparaturave dhe paisjeve mjekesore, mjeteve farmaceutike; materialeve/lendeve/produkteve/barnave farmaceutike dhe veterinerë. Funksionimi dhe administrimi i farmacive te shitjes me pakice dhe tregtimi me pakice i barnave dhe produkteve farmaceutike. Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese dhe qendrave ambulatorë te diagnostikimit ne territorin e Shqiperise. Trajtimi i mbetjeve spitalore. Aktivitet ne fushen e edukimit parashkollor, privat, çerdhe, kopsht, aktivitetet mesimdhënie ne fushen e arsimit e ciklit te ulet 9-vjecar, arsimit te mesem te profilizuar dhe te pergjithshem dhe arsimit te larte, kurse kualifikimi ne gjuhe te huaj, etj, sipas kerkeses dhe ofertes qe do te kete shoqeria nga subjekte te ndryshme private, juridike dhe shteterore.”.

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II  
KAPITALI  
Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 lekë dhe eshte nënshkruar nga “ortaku i vetem“ i shoqerise.

**Ortaku Themelues:** Arben Lutaj, atesia Dano, I datelindjes 27/07/1971, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, me Leternjoftim ID nr. 033527128 dhe nr. personal H10727090A., zoterues i 1 (nje) kuote, me vlere te pergjithshme 100 Leke, qe perbene 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Ky kapital do te ngurtesohet ne Banke pasi te dali NIPTI i shoqerise.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund

të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i Vetem është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërtëjojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9


##### Administrimi

Administrator i shoqërisë "FIAMA" shpk është Z. ARBEN LUTAJ, i cili do të ushtrojë funksionet në këto detyra për një periudhë 5 vjetore me të drejta ripërtëritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetem të shoqërisë.

#### Neni 10





## Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblësë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## Neni 11

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## Neni 12

### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblësë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne këtë rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".

#### Neni 13

##### Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 14

##### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "FIAMA" shpk dhe nenshkruset ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

#### **ORTAKU THEMELUES**





## STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "FIAMA" SHPK

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, unë ARBEN LUTAJ, si ortak i vetëm, në mbështetje të aktit të themelimit, hartoj këtë statut bazë për karakterin dhe veprimtarinë e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, qe konsiston, si më poshtë:

### KREU I

#### Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

##### Neni 1

##### Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "FIAMA" SHPK.

##### Neni 2

##### Forma Juridike

Shoqëria "FIAMA" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria").

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "FIAMA" shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

##### Neni 3

##### Selia

Shoqëria e ka seline ne adresen **ZONA KADASTRIALE 1945, NR.PAS.274/121 HEKAL, BASHKIA MALLAKASTER**, godine banimi dhe sherbimi.

Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakut te Vetem.


##### Neni 4

##### Objekti

Shoqëria "FIAMA" shpk, ka per objekt:

"Kryerjen e c'do aktiviteti të lejuar me ligj dhe pjesëmarrjen në cdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryej një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. Aktivitet ne fushen e projektive dhe hapje studio projektimi. Investitor privat dhe/ose zbatues i veprave te ndertimit, rikonstruksionit, restaurimit, mirembajtje, siper marrje te ndryshme me fonde private dhe shtetore, donacione, etj., ne fushen e ndertimit te objekteve te ndryshme civile, industriale, socialkulturore, turistike, bujqesore, landfilleve, stadiumeve, punime sipas kategorive te licences se zbatimit NP-1, NP-2, NP-3, NP-4, NP-5, NP-6, NP-7, NP-8, NP-9, NP-10, NP-11, NP-12, NS-1, NS-2, NS-3, NS-4, NS-5, NS-6, NS-7, NS-8, NS-9, NS-10, NS-11, NS-12, NS-13, NS-14, NS-15, NS-16, NS-17, NS-18, NS-19, NS-20. Agjenci per shitbjerjen e pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme. Punime mjedisore, hartim te raporteve te ndikimit ne mjedis dhe ekspertime mjedisore. Grumbullim, ruajtje, transportim dhe trajtim i mbetjeve urbane dhe mbetjeve inerte te parrezikshme. Sherbime spedicioni brenda dhe jashte Shqipërisë per transport mallrash te ndryshme me shumice e pakice, import – eksport me mjete te shoqerise. Import-eksport, tregtim me shumice dhe pakice i mallrave dhe pajisjeve te





ndryshme industriale, bujqesore, blegtorale, elektrike, hidraulike, frigoriferike, ashensor, elektro-shtepiake/industriale, kancelari dhe artikujve shkollor, blegtorale, ushqimore, pajisjeve kondicionimit dhe ventilimit, kompjutera dhe pajisje kompjuterike, printimi, fotokopjimi si dhe pjese kembimi per to, si dhe te ofroj te gjitha sherbimet/riparime qe kryhen me pajisjet e siperpermendura. Import, eksport dhe tregtim, me shumice dhe pakice te makineri, mjete, automjete, kamiona, makineri industriale, bujqesore, blegtorale, si dhe çdo lloj mjeti dhe pajisje te motorizuar dhe pjese te kembimit per keto makineri, autoservis mjetesh te markave e tonazheve te ndryshme. Dhenie me qera e mjeteve dhe automjeteve te çdo lloji. Krijimi, instalimi, dhenia me qira dhe venia ne shfrytezim e impianteve, stacioneve, reparteve, linjave per tregtimin e hidrokarbureve brenda e jashte vendit; Import-eksport dhe tregti me shumice e pakice e naftes, gazit, nenprodukteve te tyre, vajrave lubrifikante, transport kombetar e nderkombetar i tyre. Ndertimi, marrja dhe dhenia me qira dhe venia ne perdorim te depove hidrokarbure, rezervuareve te linjave dhe pikave te shitjes se tyre sipas projektit teknologjik. Sherbim hoteleri. Agjensi turistike. Import-eksport, prodhim dhe tregtimi materiale ndertimi dhe lendeve te para industrial, drusore dhe per ndertim. Hotel, bar-kafe, restorantë. Import, eksport dhe tregtim, me shumice dhe pakice te mjete mjekesore, aparaturave dhe paisjeve mjekesore, mjeteve farmaceutike; materialeve/lendeve/produkteve/barnave farmaceutike dhe veterinerë. Funkcionimi dhe administrimi i farmacive te shitjes me pakice dhe tregtimi me pakice i barnave dhe produkteve farmaceutike. Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese dhe qendrave ambulatorë te diagnostikimit ne territorin e Shqiperise. Trajtimi i mbetjeve spitalore. Aktivitet ne fushen e edukimit parashkollor, privat, çerdhe, kopsht, aktivitetet mesimdhenie ne fushen e arsimit e ciklit te ulet 9-vjecar, arsimit te mesem te profilizuar dhe te pergjithshem dhe arsimit te larte, kurse kualifikimi ne gjuhe te huaj, etj, sipas kerkeses dhe ofertes qe do te kete shoqeria nga subjekte te ndryshme private, juridike dhe shteterore.”.

#### Neni 5

#### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

### KREU II

### KAPITALI

#### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 lekë dhe eshte nënshkruar nga “ortaku i vetem“ i shoqerise:

**Ortaku Themelues:** Z.ARBEN LUTAJ, lindur më 27/07/1971, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 033527128 dhe nr. personal H10727090A, me vlere te pergjithshme 100 Leke, qe perbene 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Ky kapital do te ngurtesohet ne Banke pas rregjistrimit te shoqerise ne QKR.

#### Neni 7

#### Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit nga



gjkata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses se administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakut te Vetem të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

## Neni 8

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

## Neni 9

### Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 10

##### Administrimi

Administrator i shoqërisë "FIAMA" shpk është Z. ARBEN LUTAJ, i cili do të ushtroje funksionet në këto detyra për një periudhë 5 vjetore me të drejta ripërteritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

#### Neni 11

##### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;


Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.



## Neni 12 Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me pergjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, pergjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata pergjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a. a) u kthen ortakëve kontributet;
- a. b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- i. c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

## Neni 13 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## Neni 14 Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### Neni 15

##### Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Neni 16

##### Te ardhurat

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

#### Neni 17

##### Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "*Shoqeri ne likuidim e siper*".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 18

##### Likuiduesi

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.



## Neni 19

### Të drejtat e detyrimit e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

## Neni 20

### Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

## Neni 21

### Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

## Neni 22

### Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut të Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë: kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

2 2

2007.05.03

vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimit, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25

Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 3 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nën parim nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "FIAMA" shpk, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

**ORTAKU THEMELUES**

ARBEN

LUTAJ  
